

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Policia: Protestuesit mbrëmë rrezikuan pjesëmarrësit në trafik dhe veten
ADRESA	https://www.koha.net/arberi/policia-protestuesit-mbreme-rrezikuan-pjesemarresit-ne-trafi-k-dhe-veten
BURIMI	koha.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	20 shtator 2026, 03:18:32 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	19 shtator 2026, 08:59:19 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	de995f204e9b639f74fc2a0fb2277338bedae8a5caddeb7d3301c16ad4b275f7
TEKSTI	a5a0a6963d89e8e476116edf9ed95b6260b96ea36956ce58be8cc0806cab87a9
PAMJA	940bfa29e92a7476d01ad8d01a089edc9af8dbf35816a359de0049288a3c589e

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	5ad338c3fd0fd14346e3d1e21b3fd5af73dffcc722c3bc619d80704f529d9452
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	77f62ff964619b499e7abd6ec0b68bd7082a3350b84662b73410ae03800ae3c8
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/5ad338c3fd0fd14346e3d1e21b3fd5af73dffcc722c3bc619d80704f529d9452>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

ARBËRI

Policia: Protestuesit mbrëmë rrezikuan pjesëmarrësit në trafik dhe veten



19 shtator 2026 10:59

Shpërndaje në:



Klikoni këtu nëse dëshironi t'i lexoni lajmet e fundit dhe të përgjegjdhura në kanalën tonë zyrtar në Viber

Pavarësisht se Policia e ka vlerësuar situatën si të qetë mbrëmjen e kaluar gjatë protestës së qytetarëve në kryeqytet, ajo ka vërejtur se disa qytetarë kanë rrezikuar sigurinë në trafik. Të premtën mbrëma qytetarë kanë protestuar fillimisht në sheshin "Skënderbeu" e më pas para objektit të EULEX-it, duke kundërshtuar vendimin dënues të Gjykatës Speciale kundër ish-krerëve të UÇK-së.

Gjatë protestës nuk është raportuar për ndonjë incident në aspektin e sigurisë.

"Rreth orës 23:30 pjesëmarrësit kanë filluar të shpërndahen në mënyrë të qetë, mirëpo një numër i caktuar i tyre kanë vazhduar të zhvendosen në drejtim të bazës së EULEX-it, për të vazhduar me protestën para objektit të këtij institucioni. Pjesëmarrësit kanë qëndruar rreth 30 minuta pranë objektit të EULEX-it, dhe më pas janë nisur në drejtim të kryeqytetit, ku me automjetet e tyre kanë vazhduar të defilojnë nëpër disa rrugë të kryeqytetit. Defilimet e tyre me vetura përveç krijimit të kolonave në trafik, kanë kryer edhe vozitje të rrezikshme, madje edhe kanë shkaktuar rrezik për pjesëmarrësit e tjerë në trafik, por edhe për veten e tyre", ka njoftuar Policia në komunikatë.

Për shkak të kolonës, Policia ka thënë se është detyruar që të ndërmar masa shtesë në trafik, të ndërpres dhe riorientoj përkohësisht trafikun, me qëllim të mbarëvajtjes së sigurt të trafikut dhe shmangies së bllokimeve e aksidenteve të mundshme nga vozitjet e rrezikshme e të pakujdesshme, të cilat kanë zgjatur deri në orët e vona pas mesnatës.

Policia u ka bërë thirrje qytetarëve që të kenë kujdes të shtuar, të mos dëmtojnë pronën publike e private, të respektojnë ligjet, e në veçanti rregullat në trafikun rrugor.

Showbiz.

"Animals" e rikthen yllin Ben Affleck si regjisor

Futboll.

Rrahmani zëvendësues, Lazio mposht Veneziën

Futboll.

Raphinha i pandalshëm, Barça fiton 3:1 ndaj Sevilas

Shtojca për Kulturë.

Kur pikëllimi shndërrohet në krenari

Arbëri.

Kurti: Nevojitet strategji shtetërore për reagim ndaj verdiktit të Speciales

Basketboll.

Bora e nis edicionin e ri me fitore të thellë

Artikuj të ngjashëm



Arbëri • 8 o. më parë

Organizatorët apelojnë te partitë të mos i politizojnë protestat kundër vendimit të Speciales



Arbëri • 18 sht 2026

Policia u bën thirrje protestuesve që të mos mbajnë maska



Arbëri • 16 sht 2026

Shpërndahen protestuesit nga sheshi “Skënderbeu”



Arbëri • 6 o. më parë

Organizatorët: Nuk na ka bashkuar partia – na ka bashkuar UÇK-ja



Arbëri • 18 sht 2026

Mijëra qytetarë protestojnë kundër vendimit të Speciales ndaj ish-krerëve të UÇK-së

KOHA

Kjo faqe kontrollohet dhe menaxhohet nga KOHA. Të gjitha materialet në të, përfshirë fotografitë, janë të mbrojtura me copyright të KOHA-s dhe për to KOHA mban të drejtat e rezervuara. Materialet në këtë faqe nuk mund të përdoren për qëllime komerciale. Ndalohet kopjimi, riprodhimi, publikimi i paautorizuar qoftë original apo i modifikuar në çfarëdo mënyre, pa lejen paraprake të KOHA-s. Shfrytëzimi i materialeve nga ndonjë faqe interneti a medium tjetër pa lejen e Grupit KOHA, në emër të krejt njësisë që e përbëjnë (Koha Ditore, KohaVision, Koha.net, Botimet KOHA, KOHA Print dhe ARTA), është shkelje e drejtave të autorit dhe të pronës intelektuale sipas dispozitave ligjore në fuqi. Të gjithë shkelësit e këtyre të drejtave do të ballafaqohen me ligjin.

Marketing

Politika e privatësisë

Kushtet e përdorimit

Udhëzim për përdorimin e IA-së

Cilësimet e privatësisë dhe cookies

Përkthimi i përmbajtjeve në gjuhët tjera bëhet në mënyrë automatike dhe mund të ketë gabime!

+383 (0) 38 249 105 /

AL | EN | DE | FR | ES | GR | SR | TR | MK

Aneksi i ish-Radio Prishtinës (kati i parë) Xhorxh Bush p.n., 10000 Prishtinë

Shkarkoje aplikacionin e KOHËS

